

LIGJ
Nr. 123/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR TË HUAS NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS
PËR MBËSHTETJEN E PËRPPJEKJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR ZBUTJEN E PANDEMISË COVID-19**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja kuadër e huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë COVID-19, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.12.2021.

**Shpallur me dekretin nr. 13391, datë 17.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

LOGO

LD 2088 (2021)

MARRËVESHJE KUADËR HUAJE

ndërmjet

BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS

dhe

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Mbështetje e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë COVID-19

TABELA E PËRMBAJTJES

1. INTERPRETIMI
 - 1.1 PËRKUFIZIME
 - 1.2 INTERPRETIMI
 - 1.3 TITUJT
 - 1.4 RRUMBULLAKOËSJA
2. KUSHTET
3. QËLLIMI
4. KUSHTET FINANCIARE
 - 4.1 SHUMA E HUASË
 - 4.2 SHUMA E DISBURSIMIT
 - 4.3 PROCEDURA E DISBURSIMIT
 - 4.4 PERIUDHA E DISBURSIMIT
 - 4.5 KUSHTET E DISBURSIMIT
 - 4.6 SHLYERJA
 - 4.7 PARAPAGIMI
 - 4.8 PËRCAKTIMI I INTERESIT
 - 4.9 NORMA E KAMATËVONESËS
 - 4.10 RASTI I DEFORMIMIT TË TREGUT
 - 4.11 PAGESAT
5. ZBATIMI I PROJEKTIT
 - 5.1 DETYRIMI I KUJDESIT
 - 5.2 PERIUDHA E ALOKIMIT
 - 5.3 KOSTOT E PROJEKTIT
 - 5.4 SIPËRMARRJET SPECIFIKE TË PROJEKTIT
 - 5.5 PROKURIMI
 - 5.6 GARANCITË MJEDISORE DHE SOCIALE
 - 5.7 TË DREJTAT E NJERIUT
 - 5.8 INTEGRITETI
 - 5.9 VIZIBILITETI
6. MONITORIMI
 - 6.1 RAPORTIMET
 - 6.2 VIZITAT
 - 6.3 AUDITIMI
 - 6.4 INFORMACION MBI PROJEKTIN
 - 6.5 INFORMACION MBI HUAMARRËSIN
 - 6.6 ZOTIMET FINANCIARE
7. PARI PASSU
 - 7.1 KLASIFIKIMI
 - 7.2 GARANCIA
 - 7.3 KLAUZOLË ME ANË TË PËRFSHIRJES
 - 7.4 PARAPAGIMI PËR PALËT E TRETA
8. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË
9. PALËT E TRETA
10. MOS-HEQJA DORË
11. TRANSFERIMI
12. PALIGJSHMËRIA
13. MOSZBATIMI I KLAUZOLËS PËR RRETHANAT E PAPARASHIKUARA
14. LIGJI RREGULLUES

- 15. MOSMARRËVESHJET
- 16. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE
- 17. NJOFTIMET
- 18. TAKSAT DHE SHPENZIMET
- 19. ÇLIRIMI NGA DETYRIMET
- 20. HYRJA NË FUQI

SHTOJCA 1

SHTOJCA 2

SHTOJCA 3

SHTOJCA 4

SHTOJCA 5

SHTOJCA 6

BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EVROPËS, një organizatë ndërkombëtare me seli në adresën: 55, Avenue Kléber, 75116 Paris (Francë) (në vijim e referuar si **"CEB"** ose **"Banka"**), nga njëra anë,

dhe

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga Anila DENAJ, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si **"Huamarrësi"** dhe së bashku me CEB, **"Palët"** dhe secila një **"Palë"**) nga ana tjetër,

MEQË

- (A) Duke pasur parasysh aplikimin për hua të paraqitur nga autoritetet shqiptare më 7 maj 2021, të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB më 11 qershor,
- (B) Duke pasur parasysh Protokollin e Tretë të datës 6 mars 1959 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës, të datës 6 shtator 1949,
- (C) Duke pasur parasysh Rregulloret e Huasë të CEB, siç janë miratuar nga Rezoluta 1587 (2016) e Këshillit Administrativ të CEB (në vijim referuar si **"Rregulloret e Huasë"**),
- (D) Duke pasur parasysh Politikën e CEB për Financimin e Huave dhe Projekteve, siç është miratuar nga Rezoluta 1617(2020) e Këshillit Administrativ të CEB (në vijim e referuar si **"Politika e Huasë"**,
- (E) Duke pasur parasysh Politikën e Garancive Mjedisore dhe Sociale të CEB, siç është miratuar nga Rezoluta 1588 (2016) e Këshillit Administrativ të CEB (në vijim e referuar si **"Politika e Garancive Mjedisore dhe Sociale"**),
- (F) Duke pasur parasysh Udhëzimet e Prokurimit të CEB, siç janë miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB në shtator 2011 (në vijim të referuara si **"Udhëzimet e Prokurimit"**),
- (G) Duke pasur parasysh Rregulloren e CEB për një sistem për mbrojtjen e të dhënave personale në CEB, siç është miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB në shtator 2011 (në vijim e referuar si **"Rregullorja e Mbrojtjes së të Dhënave Personale"**),
- (H) Duke pasur parasysh Kartën Anti-Korrupsion të CEB, siç është miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB në dhjetor 2020, dhe
- (I) Duke pasur parasysh Juridiksionet Jo-bashkëpunuese/të Papajtueshme, siç është miratuar nga Rezoluta 1608 (2019) e Këshillit Administrativ të CEB,

ME ANË TË KËSAJ BIEN DAKORD SI MË POSHTË:

1. INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Termet e mëposhtme kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

"Marrëveshje" nënkupton marrëveshje kuadër financimi, duke përfshirë shtojcat e saj.

"Alokim" nënkupton angazhimin e një Transhi nga Huamarrësi për pjesët përbërëse të pranueshme të Projektit/Nënprojekteve, edhe nëse ky Transh nuk do të ishte paguar ende sipas Projektit.

"Periudhë Alokimi" ka kuptimin e përcaktuar sipas Nënklauzolës 5.2.

"Ditë Pune" nënkupton:

Në lidhje me pagesat në EURO, çdo ditë në të cilën operon TARGET 2 (Sistemi Automatik Transevropian i Transfertave Ekspres në Kohë Reale të Shlyerjeve Bruto).

"Certifikatë" ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.5 dhe formularin e përcaktuar sipas Shtojcës 5 të kësaj Marrëveshjeje.

"Datë Mbylljeje" nënkupton datën e specifikuar sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje nga e cila nuk mund të zhvillohen disburse të mëtejshme sipas Huasë.

"Raport Përfundimi" ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 6.1(c).

"Komponentë" nënkupton sektorët e pranueshëm të veprimit të përcaktuar sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

"Rast i Mospërbushjes së Tërthortë të Detyrimeve" ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 6.6.

"Monedhë" nënkupton, për qëllimet e Marrëveshjes, EURO.

"Marrëveshje e Përcaktimit të Ditëve" nënkupton marrëveshjen për përcaktimin e numrit të ditëve ndërmjet dy datave dhe numrin e ditëve në vit siç specifikohet në Njoftimin Përkatës të Disbursimit.

"Instrument borxhi" nënkupton (i) çdo hua ose formë tjetër të borxhit financiar; (ii) një instrument, duke përfshirë një dëftesë ose pasqyrë llogarie që provon ose përbën një detyrim për të shlyer një hua, depozitë, parapagim apo shtyrje të ngjashme kredie (duke përfshirë pa kufizim çdo shtyrje të kredisë në bazë të një marrëveshjeje rifinancimi dhe riskedulimi); (iii) një obligacion, notë, garanci borxhi, dëftesë borxhi apo provë të ngjashme me shkrim të borxhit financiar; ose (iv) një instrument që provon një garanci të një detyrimi që përbën borxh financiar të tjetrës.

"Normë e Kamatëvonesës" ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.9.

"Datë Disbursimi" nënkupton datën kur është skeduar disbursimi i një Transhi në përputhje me Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

"Njoftim Disbursimi" ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.3(b).

"Kërkesë Disbursimi" ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.3 (a).

"Datë e Hyrjes në Fuqi" nënkupton datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes që rezulton nga Klauzola 20.

"BE" nënkupton Bashkimin Evropian.

"EURIBOR" nënkupton normën e përqindjes të kuotuar nga ndonjë dhënësi i lajmeve financiare, të zbatueshme për CEB në ose rreth orës 11 paradite me kohën e Brukselit në Datën e Përcaktimit të Interesit, si norma e financimit për biznese të tregtisë me shumicë në EURO e administruar nga Instituti Evropian i Tregut Monetar (ose ndonjë subjekt tjetër që merr në dorëzim administrimin e asaj përqindjeje) për të njëjtën periudhë si Periudha përkatëse e Interesit.

Nëse Periudha përkatëse e Interesit nuk është e njëjtë me periudhën e kuotuar nga dhënësi përkatës i lajmeve financiare, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes që rezulton nga interpolimi linear duke iu referuar dy (2) normave të EURIBOR-it, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë të ardhshme më të shkurtër muajsh të plotë dhe tjetra për një periudhë të ardhshme më të gjatë prej muajsh të plotë sesa kohëzgjatja e Periudhës përkatëse të Interesit.

"EURO" dhe simboli **"EURO"** nënkupton monedhën e ligjshme të Shteteve Anëtare të BE-së, të cilat herë pas here e miratojnë atë si monedhën e tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktatit të BE-së dhe Traktatit për Funksionimin e BE-së apo traktatet e tjera vijuese.

"Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut" nënkupton Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950, CETS Nr. 5, e ndryshuar herë pas here.

"Kartë Sociale Evropiane" nënkupton Kartën Sociale Evropiane të datës 3 maj 1996, CETS Nr. 163, të ndryshuar herë pas here.

"Përfitues Përfundimtarë" janë specifikuar sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje, si grupi përfitues i ndikimeve sociale të Projektit.

"Normë Fikse Interesi" nënkupton normën e interesit në vit të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

"Normë e Ndryshueshme Interesi" nënkupton normën e interesit në vit të përcaktuar duke shtuar ose zbritur Diferencën e specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit deri ose nga, sipas rastit, Norma Referuese.

Për shmangien e dyshimit, kur përcaktimi i Normës së Ndryshueshme të Interesit rezulton në një normë negative interesi (për shkak të një Norme negative Referuese të kuotuar, për kryerjen e një Diference që është zbritur nga Norma Referuese ose në rrethana të tjera), interesi për t'u paguar nga Huamarrësi për Periudhën e Interesit konsiderohet të jetë zero.

"Datë Përcaktimi e Normës së Interesit" nënkupton, për qëllimet e përcaktimit të një Normë të Ndryshueshme Interesi, ditën që bie dy (2) Ditë Pune para datës së parë të Periudhës së Interesit, nëse nuk specifikohet ndryshe në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

"Data të Pagesës së Interesit" nënkupton datat për pagesën e interesit që korrespondojnë me Periudhën përkatëse të Interesit të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

"Periudhë Interesi" nënkupton periudhën që fillon në një Datë Pagese Interesi dhe që përfundon menjëherë një ditë para Datës së ardhshme të Pagesës së Interesit, me kusht që Periudha e parë e zbatueshme e Interesit për secilin Transh të fillojë në Datën e Disbursimit dhe të përfundojë menjëherë një ditë para Datës së ardhshme të Pagesës së Interesit.

"Hua" nënkupton huanë e dhënë Huamarrësit nga CEB-I me anë të Marrëveshjes.

“Shumë HuaJe” nënkupton shumën e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.1.

“Rast i Deformimit të Tregut” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.10.

“Ndryshim Material Negativ” nënkupton çdo ngjarje që në opinionin e CEB, (i) dëmton materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij financiare sipas Marrëveshjes; (ii) ndikon negativisht në ndonjë Garanci të dhënë nga Huamarrësi ose një palë e tretë për të siguruar përmbushjen e duhur të detyrimeve financiare të Huamarrësit sipas Marrëveshjes; ose (iii) ndikon negativisht në të drejtat ose mjetet ligjore të CEB sipas Marrëveshjes.

“Datë Maturimi” nënkupton Datën e fundit të Shlyerjes së Principalit për secilin Transh të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit

“Marrëveshje e Ditës së Ndryshuar të ardhshme të Punës” nënkupton një marrëveshje me anë të së cilës, nëse një datë e specifikuar do të binte në një ditë që nuk është Ditë Pune, ajo datë do të ishte dita e parë e ardhshme që është një Ditë Pune, nëse ajo ditë nuk bie në muajin e ardhshëm kalendarik, rast në të cilin ajo datë do të ishte dita e parë pararendëse që është një Ditë Pune.

“Konfirmim Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Kosto Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Datë Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Njoftim Parapagimi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 4.7.

“Datë (a) për Shlyerjen e Principalit” nënkupton datën (at) për shlyerjen (et) e principalit sipas secilit Transh të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

“Periudhë e Shlyerjes së Principalit” nënkupton në lidhje me secilin Transh, periudhën që fillon nga Data e tij e Disbursimit deri në Datën e tij të Maturimit.

“Raport Progresi” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 6.1(b).

“Praktika të Ndalura” ka kuptimin e specifikuar sipas Nënklauzolës 0.

“Projekt” nënkupton masat e lidhura me COVID 19 të përcaktuara sipas Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje, të cilat do të financohen pjesërisht me Huanë e miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB me referencë LD 2088 (2021).

“Normë Referuese” nënkupton EURIBOR-in për një Transh me Normë të Ndryshueshme Interesi të caktuar në EURO.

“Lista të Sanksioneve” nënkupton çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh të lëshuar nga BE-ja në përputhje me kapitullin 2 të titullit V të Traktatit për Bashkimin Evropian; si dhe Nenin 215 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, siç është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit¹ të BE-së ose ndonjë faqe vijuese, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here; ose (ii) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh, të lëshuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në përputhje me Nenin 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, siç është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit të Kombeve të Bashkuara ose në çdo faqe vijuese, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here.

“Persona të Sanksionuar” nënkupton çdo individ ose subjekt të listuar në dhe/ose ndryshe që i nënshtrohet një ose më shumë Listave të Sanksioneve.

¹ http://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en.

"**Garanci**" nënkupton çdo marrëveshje ose masë që krijon një shkallë preferenciale, një të drejtë preferenciale pagese, një kolateral ose garanci të çfarëdo natyre, e cila mund t'i japë të drejta të zgjeruara palëve të treta

"**Diferencë**" nënkupton, në lidhje me Transhet me Normë të Ndryshueshme Interesi, diferencën fikse ndaj Normës Referuese (që është ose plus, ose minus) të specifikuar në pikë bazë në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

"**Transh**" nënkupton një shumë të disbursuar ose që do të disbursohet sipas Huasë.

1.2 Interpretimi

Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, referencat për:

- (i) këtë Marrëveshje interpretohen si referenca për këtë Marrëveshje të cilat herë pas here plotësohen, ndryshohen ose ripërcaktohen;
- (ii) një Palë ose ndonjë person tjetër përfshin pasuesit e tij në titull ose të transferuarit e tij të lejuar ;
- (iii) "Klauzola", "Nënklauzola" dhe "Pika" interpretohen si referenca ndaj klauzolave, nënklauzolave dhe pikave përkatësisht në këtë Marrëveshjeje; dhe
- (iv) Fjalët e përdorura në njëjës do të përfshijnë shumësin dhe anasjelltas

1.3 Titujt

Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

1.4 Rrumbullakosja

Për qëllimet e llogaritjeve të përmendura në këtë Marrëveshje:

- (i) të gjitha përqindjet që rezultojnë nga llogaritje të tilla përveç atyre të përcaktuara nëpërmjet përdorimit të interpolimit, rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, në më të afërtën e njëqind të mijtës të një pike përqindjeje (p.sh., 9.876541% (ose .09876541) duke u rrumbullakosur në 9.87654% (ose.0987654) dhe 9.876545% (ose .09876545) duke u rrumbullakosur deri në 9.87655% (ose .0987655));
- (ii) të gjitha përqindjet e përcaktuara nëpërmjet përdorimit të interpolimit linear duke iu referuar dy (2) Normave përkatëse Referuese, do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, në përputhje me metodën e përcaktuar në nënparagrafin (i) më sipër, por në të njëjtën shkallë saktësie si dy (2) normat e përdorura për të bërë përcaktimin (përveç kur përqindje të tilla nuk do të rrumbullakosen në një shkallë më të ulët saktësie sesa e një e mijta e një pike përqindjeje (0.001%)); dhe
- (iii) të gjitha shumat e monedhës të përdorura në ose që rezultojnë nga llogaritjet e mësipërme do të rrumbullakosen, përveç nëse specifikohet ndryshe në përkufizimin përkatës të Monedhës, në dy numrat dhjetorë më të afërt në monedhën përkatëse (me .005 të rrumbullakosura lart (p.sh., .674 rrumbullakuar poshtë në .67 dhe .675 që rrumbullakoset deri në .68).

2. KUSHTET

Huaja jepet sipas kushteve të përgjithshme të Rregulloreve të Huasë dhe kushteve të veçanta të Marrëveshjes.

3. QËLLIMI

CEB i jep Huanë Huamarrësit, i cili e pranon atë, vetëm për qëllim të financimit të Projektit siç përshkruhet sipas Shtojcës 1.

Çdo ndryshim në mënyrën si aplikohet huaja që nuk ka marrë miratimin paraprak me shkrim të CEB do të përbënte një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në rimbursimin, pezullimin ose anulimin para kohe të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

4. KUSHTET FINANCIARE

4.1 Shuma e Huasë

Shuma e Huasë është:

gjashtëdhjetë milionë EURO
60 000 000 EURO

4.2 Shuma e Disbursimit

Huaja disbursohet në minimalisht dy (2) Transhe.

Shuma e çdo transhi përcaktohet sipas kapacitetit përthithës të Projektit. Shuma e Transhit të parë nuk duhet të tejkalojë shtatëdhjetë për qind (70%) të Shumës së Huasë.

4.3 Procedura e Disbursimit

Disbursimi i çdo Transhi përcaktohet nëpërmjet procedurës së mëposhtme:

(a) Kërkesë Disbursimi

Çdo Transh do të disbursohet sipas procedurës së mëposhtme:

Para çdo disbursimi, Huamarrësi i paraqet CEB një kërkesë disbursimi kryesisht në formën e përcaktuar sipas Shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim e referuar si "**Kërkesë Disbursimi**").

Një Kërkesë Disbursimi specifikon:

- (i) Monedhën(at) dhe shumën(at) e propozuar/a për Transhin;
- (ii) Datën e Disbursimit;
- (iii) Datën/datat e Shlyerjes së Principalit, duke përfshirë Datën e Maturimit, duke marrë parasysh se Periudha e Shlyerjes së Principalit për secilin Transh nuk duhet të tejkalojë pesëmbëdhjetë (15) vjet.
- (iv) Normën Fikse Maksimale të Interesit ose Diferencën maksimale të Normës Referuese;
- (v) Periudha e Interesit dhe Datat e Pagesës së Interesit;

(vi) Marrëveshjen e Përcaktimit të Ditëve dhe Ditët e Punës; dhe

(vii) Llogarinë e Huamarrësit për pagesa.

Çdo Kërkesë Disbursimi Huaje që i dorëzohet CEB është e parevokueshme, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB.

(b) Njoftimi i Disbursimit

Nëse CEB merr një Kërkesë Disbursimi që përputhet me kërkesat e Kërkesës për Disbursim të përcaktuara në Nënklauzolën 4.3(a) më sipër dhe nëse të gjitha Kushtet e tjera përkatëse të Disbursimit të përcaktuara më poshtë në Nënklauzolën 4.5 (*Kushtet e Disbursimit*) janë plotësuar nga Huamarrësi, CEB do t'i dorëzojë Huamarrësit një njoftim disbursimi kryesisht në formën e përcaktuar sipas Shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim i referuar si "**Njoftim Disbursimi**"). Çdo Njoftim Disbursimi duhet të dorëzohet të paktën dy (2) Ditë Pune para Datës së propozuar të Disbursimit.

Një Njoftim Disbursimi duhet të specifikojë:

(i) Monedhën (at) dhe shumën (at) për Transhin;

(ii) Datën e Disbursimit;

(iii) Periudhën e Shlyerjes së Principalit dhe Datën/Datat e Shlyerjes, duke përfshirë Datën e Maturimit;

(iv) Normën Fikse të Interesit ose Diferencën ndaj Normës Referuese;

(v) Periudhën e Interesit dhe Datat e Pagesës së Interesit;

(vi) Marrëveshjen e Përcaktimit të Ditëve dhe Ditët e Punës; dhe

(vii) Llogaritë e Huamarrësit dhe CEB për pagesat

Një Njoftim Disbursimi që plotëson elementët e përfshirë në një Kërkesë Disbursimi Huaje përbën një angazhim të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për të marrë hua nga CEB dhe nga ana e CEB për t'i disbursuar Huamarrësit Transhin sipas termave dhe kushteve të specifikuara në Njoftimin e Disbursimit.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse CEB nuk ka dorëzuar një Njoftim Disbursimi brenda njëzet (20) Ditësh Pune pas marrjes së Kërkesës për Disbursim, kërkesa përkatëse për Disbursim do të konsiderohet e anuluar.

4.4 Periudha e Disbursimit

Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB, Huamarrësi nuk ka të drejtë:

(i) të lëshojë një Kërkesë Disbursimit për Transhin e parë pas dymbëdhjetë (12) muajve pas ekzekutimit të Marrëveshjes nga Palët ose pas njëzetë e katër (24) muajsh pas miratimit të aplikimit për hua nga Këshilli Administrativ i CEB, cilado që ndodh më herët;

(ii) të lëshojë ndonjë Kërkesë tjetër Disbursimi pas tetëmbëdhjetë (18) muajve pas disbursimit të fundit; ose

(iii) të lëshojë ndonjë Kërkesë tjetër Disbursimi pas datës që bie pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune para Datës së Mbylljes.

4.5 Kushtet e Disbursimit

a) Kushtet para Kërkesës për Disbursim për Transhin e parë:

- (i) Një opinion ligjor në anglisht të lëshuar nga drejtuesi i departamentit juridik të Huamarrësit që konfirmon sipas pëlqimit të CEB, kryesisht në formën e përcaktuar sipas Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, se Marrëveshja është ekzekutuar sipas rregullave nga përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësit dhe se Marrëveshja është e vlefshme, e detyrueshme dhe e zbatueshme në përputhje me kushtet në juridiksionin e Huamarrësit.
- (ii) Dëshmi në gjuhën angleze (p.sh., statut, rezolutë, prokurë etj.), sipas pëlqimit të CEB, të personit(ave) të autorizuar për ekzekutimin e Marrëveshjes dhe Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit, së bashku me modelin e vërtetuar të nënshkrimit (eve) të këtij personi/këtyre personave.
- (iii) Një Certifikatë nga Huamarrësi në formën e Shtojcës 5 të kësaj Marrëveshjeje, të nënshkruar nga personi (at) e autorizuar për ekzekutimin e Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit dhe me datë jo më herët sesa një datë që bie pesë (5) Ditë Pune para Kërkesës për Disbursim.

b) Kushtet pararendëse për ndonjë Kërkesë tjetër Disbursimi:

- (i) Dëshmi në gjuhën angleze (p.sh., Statut, Rezolutë, Prokurë etj), sipas kërkesave të CEB, të personit(ave) të autorizuar për ekzekutimin e Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit, së bashku me modelin e vërtetuar të nënshkrimit (eve) të këtij personi/këtyre personave.
- (ii) Raport Progresi që konfirmon, sipas pëlqimit të CEB, Alokimin e plotë (100%) të Transhit të mëparshëm.
- (iii) Një Certifikatë nga Huamarrësi në formën e Shtojcës 5, të nënshkruar nga personi (at) e autorizuar për ekzekutimin e Kërkesave për Disbursim në emër të Huamarrësit dhe me datë jo më herët sesa një datë që bie pesë (5) Ditë Pune para Kërkesës për Disbursim.

4.6 Shlyerja

Në çdo Datë Shlyerjeje Principali Huamarrësi shlyen principalin e çdo Transhi të kërkueshëm në atë Datë të Shlyerjes së Principalit në përputhje me kushte të përcaktuara në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

4.7 Parapagimi

(a) Mekanizmat

Nëse në ndonjë rast të specifikuar në këtë Marrëveshje që i referohet kësaj Nënklauzole, Huamarrësi duhet të parapaguajë të gjithë ose ndonjë pjesë të një Transhi ose në rast të një parapagimi vullnetar, Huamarrësi duhet t'i japë CEB të paktën një (1) muaj para njoftim me shkrim (në vijim i referuar si "**Njoftimi i Parapagimit**") që specifikon shumat që do të parapagohen, datën kur do të kryhet parapagimi (në vijim e referuar si "**Data e Parapagimit**") dhe, pas konsultimit paraprak me CEB, Kostot e Parapagimit. Data e Parapagimit bie në një Datë Pagese Interesi, nëse nuk bihet dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i.

Pas marrjes së Njoftimit të Parapagimit, CEB do t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim me shkrim (në vijim i referuar si "**Konfirmimi i Parapagimi**"), jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune para Datës së Parapagimit që specifikon interesin e shtuar të kërkueshëm mbi të dhe Kostot e Parapagimit në pajtim me Nënklauzolën 4.7 (b).

Një Konfirmim Parapagimi që i përshtatet të gjithë elementëve të përfshirë në Njoftimin e Parapagimit përbën një angazhim të përvokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për parapagimin e shumave përkatëse për CEB sipas termave dhe kushteve të specifikuara në Konfirmimin e Parapagimit.

Nëse Huamarrësi parapaguan pjesërisht një Transh, shuma e parapaguar do të aplikohet proporcionalisht për çdo shlyerje të principalit të papaguar. Në një rast të tillë, Konfirmimi i Parapagimit do të përfshijë, në përputhje me rrethanat, një skedul të përshtatur shlyerjeje i cili do të jetë i detyrueshëm për Huamarrësin.

(b) **Kostot e Parapagimit**

Kostot që rezultojnë nga parapagimi në përputhje me Nënklauzolën 4.7 (a) (në vijim të referuara si « **Kosto Parapagimi** ») përcaktohen nga CEB në bazë të kostove të rishpërndarjes së shumës që do të parapaguhet nga Data e Parapagimit deri në Datën e Maturimit, duke përfshirë edhe ndonjë kosto të ngjashme, të tilla si ndryshimin e ndonjë mase themelore mbrojtëse. Kostot e rishpërndarjes do të përcaktohen mbi bazën e diferencës ndërmjet normës fillestare dhe normës së rishpërndarjes e cila do të përcaktohet nga CEB-i në bazë të kushteve të tregut në datën e Njoftimit të Parapagimit.

4.8 Përcaktimi i Interesit

Huamarrësi paguan interes mbi principalin e çdo Transhi herë pas here të papaguar gjatë çdo Periudhë Interesi në Normën Fikse të Interesit/Normën e Ndryshueshme të Interesit të specifikuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit.

Interesi (i) shtohet duke filluar nga dhe përfshirë ditën e parë të Periudhës së Interesit, por duke përjashtuar ditën e fundit të kësaj Periudhe interesi; dhe (ii) është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në Datat e Pagesës së Interesit të përcaktuara në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit. Interesi llogaritet në bazë të Marrëveshjes së Përcaktimit të Ditëve të specifikuar në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

Në rastin e Transheve të Normës së Interesit të Ndryshueshëm, CEB përcakton për secilën Datë të Përcaktimit të Interesit normën e zbatueshme të interesit gjatë Periudhës përkatëse të Interesit, në përputhje me Marrëveshjen dhe menjëherë njofton për këtë Huamarrësin. Çdo përcaktim nga CEB është përfundimtar, vendimtar dhe detyrues për Huamarrësin, përveç nëse i provohet CEB nga Huamarrësi se një përcaktim i tillë është një gabim i qartë.

4.9 Norma e Kamatëvonesës

Në rast se Huamarrësi nuk mund të paguajë, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë shumë sipas Marrëveshjes, dhe pavarësisht çdo mjeti tjetër të disponueshëm nga CEB sipas Marrëveshjes, Huamarrësi do të paguajë interes mbi shumën e papaguar nga data e pagesës deri në datën e marrjes së një pagesë të tillë nga CEB në normën e interesit vjetor të barabartë me EURIBOR njëmuajor, të kuotuar në datën e caktuar të pagesës plus dyqind pikë-bazë (200 pikë bazë) (në vijim të referuar si "**Norma e Kamatëvonesës**").

Norma e zbatueshme e Kamatëvonesës do të përditësohet çdo tridhjetë (30) ditë kalendrike

4.10 Rasti i Deformimit të Tregut

CEB-i, pas marrjes dijeni, do të njoftojë Huamarrësin për ndodhjen e një Rasti Deformimi Tregu.

Për qëllimet e Marrëveshjes, një "**Rast i Deformimit të Tregut**" i referohet rrethanave të mëposhtme:

- (a) Ofruesi përkatës i lajmeve financiare i përmendur sipas përkufizimit të EURIBOR-it nuk kuoton ndonjë normë përqindjeje ose faqja e normës korresponduese standard të interesit të tregut nuk është e aksesueshme.

Sipas një Rasti të tillë të Deformimit të Tregut, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga CEB si mesatarja aritmetike e normave në të cilat huatë në EURO, në një shumë të njëjtë apo sa më të afërt të krahasueshme me shumën e Huasë në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë ose sa më të përafërt të krahasueshme me Periudhën përkatëse të Interesit, janë ofruar nga tre banka (3) kryesore në tregun ndërbankar të BE-së

të zgjedhur nga CEB. Nëse janë ofruar të paktën dy (2) kuotime, EURIBOR-i i zbatueshëm për atë Datë Përcaktimi Interesi do të jetë mesatarja aritmetike e të gjitha kuotimeve të ofruara.

Nëse është ofruar vetëm një (1) kuotim ose asnjë kuotim, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga CEB si mesatarja aritmetike e normave në të cilat huatë në EURO, në një shumë të njëjtë apo sa më të afërt të krahasueshme me shumën e Huasë në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë apo sa më të afërt të krahasueshme me Periudhën përkatëse të Interesit, janë ofruar në Ditën e dytë të Punës pas fillimit të Periudhës përkatëse të Interesit nga bankat kryesore në tregun ndërbankar të BE-së të zgjedhur nga CEB.

- (b) CEB vendos se nuk është e mundur të përcaktohet Norma e zbatueshme e Referencës në përputhje me paragrafin e mësipërm (a).

Sipas një Rasti të tillë Deformimi të Tregut, Norma e zbatueshme e interesit të Ndryshueshëm do të zëvendësohet me normën që shpreh si një normë përqindje në vit koston e financimit të Huasë së CEB nga çfarëdo burimi të cilin CEB e çmon të arsyeshëm për t'u zgjedhur.

- (c) Në çdo kohë midis dorëzimit të një Njoftimi Disbursimi dhe Datës së Disbursimit, CEB konstaton në mënyrë të arsyeshme se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikuara të natyrë ekonomike, financiare, politike apo natyre tjetër të jashtme që ndikojnë negativisht në aksesin e CEB në burimet e tij të financimit.

Në një rast të tillë Deformimi Tregu, CEB ka të drejtë ta anulojë disbursimin e planifikuar pa asnjë kosto.

Në Rastet e Deformimit të Tregut të përcaktuara në pikat (a) dhe (b) më sipër (të ndryshme nga Rasti i Zëvendësimit i EURIBOR-it) :

- (i) Nëse Huamarrësi e kërkon, Palët, duke vepruar në mirëbesim, do të hyjnë në negociata për një periudhë jo më të gjatë se tridhjetë ditë (30) kalendarike, në mënyrë që të bien dakord mbi një alternativë për EURIBOR-in e zbatueshëm. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, Huamarrësi mund të vijojë me parapagimin në Datën pasuese të Pagesës së Interesit sipas kushteve të përcaktuara në Nënklauzolën 4.7
- (ii) CEB ka të drejtë, duke vepruar në mirëbesim dhe në konsultim me Huamarrësin në masën që është arsyeshmërisht e mundur, të ndryshojë kohëzgjatjen e çdo Periudhe pasuese Interesi deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike ose periudhë më të shkurtër, duke i dërguar Huamarrësit një njoftim për këtë qëllim. Çdo ndryshim i tillë në një Periudhë Interesi hyn në fuqi në datën e specifikuar në këtë njoftim nga CEB.

Nëse CEB përcakton se Rasti përkatës i Deformimit të Tregut nuk ekziston më, atëherë në bazë të ndonjë Rasti tjetër të Deformimit të Tregut aktual ose ekzistues, Norma e Ndryshueshme e Interesit dhe/ose Periudha e Interesit e zbatueshme për Transhin përkatës do të kthehen, që nga dita e parë e Periudhës pasuese të Interesit, tek llogaritja në përputhje me Normën e Ndryshueshme të Interesit dhe Periudhën e Interesit të specifikuar në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

4.11 Pagesat

Të gjitha shumatat e detyrueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje janë të pagueshme në Monedhën e secilit Transh në llogarinë e CEB të përcaktuar në Njoftimin e zbatueshëm të Disbursimit. Çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bëhet në Ditën e Punës në bazë të Marrëveshjes së ndryshuar të Ditës së ardhshme të Punës. Çdo pagesë konsiderohet e kryer pasi CEB të ketë marrë shumën në llogari të tij.

Huamarrësi ose banka e udhëzuar nga Huamarrësi, sipas rastit, i dërgon CEB një njoftim pagese me shkrim të paktën pesë (5) Ditë Pune para pagesës së çdo shume të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

Të gjitha pagesat që do të kryhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të llogariten dhe do të bëhen pa (dhe falas dhe pa asnjë zbritje për) shlyerjen ose kundërpretendimin.

Nëse CEB merr një pagesë që është e pamjaftueshme për të shlyer të gjitha shumat e kërkueshme dhe të pagueshme në atë kohë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, CEB do të aplikojë atë pagesë në ose ndaj pagesës:

(I) së pari, të tarifave, kostove, tarifave ose shpenzimeve të kërkueshme por të papaguara sipas kësaj Marrëveshjeje;

(II) së dyti, çdo interesi të shtuar të kërkueshëm por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje,

(III) së treti, çdo principal të kërkueshëm por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

(IV) së katërti, çdo shume tjetër të kërkueshme por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

5. ZBATIMI I PROJEKTIT

Huamarrësi, përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zbaton Projektin në përputhje me Marrëveshjen.

Moszbatimi i sipërmarrjeve të përcaktuara këtu sipas Nenit 5 do të përbënte, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e zbatueshme e Rregulloreve të Huasë, një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në (i) shpenzimet e kontratës përkatëse të deklaruara të papërshtatshme për Alokim sipas Projektit; dhe/ose (ii) rimbursimin, pezullimin ose anulimin para kohe të Huasë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

5.1 Detyrimi i Kujdesit

Huamarrësi ofron të gjithë kujdesin dhe përpjekjet dhe përdor të gjitha mjetet zakonisht të përdorura (duke përfshirë, por pa u kufizuar në mjetet ligjore, financiare, drejtuese dhe teknike) të kërkuara për zbatimin e duhur të Projektit.

5.2 Periudha e Alokimit

Huamarrësi alokon secilin Transh në projekt brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas Datës përkatëse të Disbursimit (në vijim e referuar si "**Periudha e Alokimit**"), përveç nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB.

Nëse një Transh i disbursuar nga CEB nuk alokohet Projektit ose i është alokuar vetëm pjesërisht brenda Periudhës së Alokimit, Huamarrësi vijon me parapagimin e shumave të pa-alokuara në Datën tjetër të Pagesës së Interesit, në kushtet e parashikuara në Nënklauzolën 4.7.

5.3 Kostot e Projektit

Transhet e disbursuara sipas Huasë nuk kalojnë nëntëdhjetë përqind (90%) të kostove totale të pranueshme të Projektit të specifikuara në Shtojcën 1 të saj. Nëse Transhet e disbursuara sipas Huasë tejkalojnë nivelin e mësipërm 90% (me ulje të kostove totale të pranueshme ose ndryshe), Huamarrësi vijon me parapagimin e tepricës në Datën tjetër të Pagesës së Interesit, në kushtet e parashikuara në Nënklauzolën 4.7.

Nëse kostot totale të pranueshme të Projektit rriten ose rishikohen për çfarëdo arsye, Huamarrësi do të sigurojë që burimet shtesë financiare për përfundimin e Projekteve janë të disponueshme pa ndonjë mjet tjetër nga CEB. Planet për të financuar kostot e rritura i komunikohen CEB pa vonesë.

5.4 Sipërmarrjet Specifike të Projektit

Huamarrësi siguron që:

- (i) të gjitha të drejtat dhe lejet për tokën, pronën e patundshme dhe lejet e kërkuara për zbatimin e Projektit janë të disponueshme në kohë;
- (ii) të gjitha pasuritë dhe impiantet në bazë të Projektit janë të siguruar përgjithmonë, mirëmbahen dhe operohen në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare;
- (iii) vaksinat COVID-19 dorëzohen në sasi të shënuara siç duhet me numrin e autorizimit nga Agjencia Kombëtare Shqiptare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore (AKShBPM).

5.5 Prokurimi

Prokurimi i furnizimeve, punëve dhe shërbimeve që do të financohen në bazë të Projektit duhet të jenë në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit.

5.6 Masat Mjedisore dhe Sociale

Huamarrësi zbaton Projektin në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Politikën e Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale.

5.7 Të Drejtat e Njeriut

Huamarrësi siguron që zbatimi i Projektit të nuk çon në shkelje të (i) Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ose (ii) Kartës Sociale Evropiane.

5.8 Integriteti

Huamarrësi merr përsipër që:

- (a) do të krijojë dhe më pas zbatojë politikën, procedurat dhe kontrollet e brendshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, me qëllim parandalimin e Huamarrësit që të bëhet, në lidhje me zbatimin e Projektit ose ndryshe, një instrument për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit;
- (b) nuk do të vendosë të ardhura nga Huaja në dispozicion ose për përfitim, drejtpërdrejt ose indirekt, ndonjë personi të Sanksionuar;
- (c) nuk do të kryejë, dhe asnjë person, me pëlqimin ose dijeninë e tij të mëparshme, nuk do të kryejë, në lidhje me zbatimin e Projektit ose ndonjë Nën-projekti, një Praktikë të Korrupsionit, një Praktikë Mashtruese, një Praktikë Shtrënguese, një Praktikë Bashkëpunuese ose një Praktikë Penguese (në vijim, së bashku me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe vënien në dispozicion të të ardhurave nga Huaja për Personat e Sanksionuar të referuar si "**Praktikat e Ndaluar**").

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- (i) "**Praktikë e Korrupsionit**" nënkupton çdo akt të ofrimit, dhënies, marrjes ose kërkimit, drejtpërdrejt ose indirekt, të çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale tjetër.
- (ii) "**Praktikë Mashtruese**" nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që me qëllim ose në mënyrë të pakujdesshme mashtron, ose përpiqet të mashtrojë, një palë për të marrë një përfitim financiar ose ndonjë përfitim tjetër, ose për të shmangur një detyrim.
- (iii) "**Praktikë Shtrënguese**" nënkupton çdo veprim të keqësimit ose dëmtimit, ose kërcënimit për të keqësuar ose dëmtuar, direkt ose indirekt, çdo palë ose pronë të ndonjë pale për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale.
- (iv) "**Praktikë Bashkëpunuese**" nënkupton çdo marrëveshje midis dy ose më shumë palëve, e krijuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një pale tjetër.
- (v) "**Praktikë Penguese**" do të thotë, në lidhje me një hetim mbi një Praktikë Shtrënguese, Bashkëpunuese, Korrupsive ose Mashtruese, (a) çdo akt të shkatërrimit, falsifikimit, ndryshimit ose fshehjes së qëllimshme të provave për hetimin; (b) çdo akt kërcënimi,

ngacmimi ose frikësimi të cilitdo pale për ta penguar atë nga informimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin ose për të ndjekur hetimin; dhe/ose (c) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e të drejtave kontraktuale të auditimit ose aksesit në informacion.

Huamarrësi merr përsipër të informojë CEB nëse duhet të vihet në dijeni për ndonjë fakt ose informacion që sugjeron kryerjen e ndonjë praktike të tillë të ndaluar.

Huamarrësi merr përsipër:

- (i) të ndërmarrë në kohë një veprim të tillë që CEB mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të hetuar dhe/ose përfunduar çdo Praktikë të Ndaluar të pretenduar ose aktuale;
- (ii) të lehtësojë çdo hetim që CEB mund të kryejë në lidhje me ndonjë Praktikë të Ndaluar të pretenduar ose aktuale; dhe
- (iii) të informojë CEB për masat e marra për të kërkuar dëmshpërblim nga personat përgjegjës për çdo humbje që rezulton nga ndonjë Praktikë e tillë e Ndaluar.

Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë do të jetë përgjegjës për kontaktet me CEB për qëllimet e kësaj Nënklauzole.

5.9 Vizibiliteti

Huamarrësi do të informojë Huamarrësit Përfundimtarë se Projekti financohet pjesërisht nga CEB përmes mjeteve të përshtatshme të komunikimit, të tilla si njoftime të dhëna në faqet përkatëse të internetit, media sociale, njoftime për shtyp, broshura ose ekspozita të posterave/tabelave në faqet / objektet përkatëse të Projektit. Në çdo rast, informacioni për Huamarrësit Final do të tregojë në një mënyrë të përshtatshme emrin dhe logon e CEB.

6. MONITORIMI

6.1 Raportimi

(a) Raportet e Progresit

Huamarrësi do t'i dërgojë CEB një raport progresi (në vijim i referuar si "**Raporti i Progresit**") (i) çdo gjashtë muaj deri në përfundimin e Projektit; dhe (ii) para çdo Kërkese për Disbursim, përveç Kërkesës për Disbursim për Transhin e parë.

Shtojca 6 këtu paraqet një model që specifikon informacionin minimal të kërkuar nga CEB. Mund të përdoren gjithashtu formatet alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

Në rast se ndonjë Nën-projekt për të cilin është ndarë Transhi nuk përputhet me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Shtojcën 1 të tij, Huamarrësi do të alokojë në kohë shumëat përkatëse për Nën-projekte të tjera të pranueshme ose përndryshe i parapaguan CEB shumëat e palokuara në përputhje me Nënklauzolën 4.7.

(b) Raporti i Përfundimit

Pas përfundimit të Projektit, Huamarrësi paraqet një raport përfundimi (në vijim i referuar si "**Raporti i Përfundimit**").

Në Shtojcën 6 paraqitet një model që specifikon informacionin minimal të kërkuar nga CEB. Gjithashtu, mund të përdoren formatet alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

6.2 Vizitat

Huamarrësi merr përsipër të pranojë në mënyrë të favorshme çdo vizitë monitorimi/teknike/vlerësimi, duke përfshirë lehtësimin e aksesit në vendpunimet/kontraktorët përkatës të Projektit, të kryera nga anëtarët e stafit të CEB ose palët e treta të përcaktuara.

6.3 Kontrolli

Nëse Huamarrësi nuk zbaton ndonjë nga sipërmarrjet e tij sipas Marrëveshjes, Huamarrësi merr përsipër të marrë në mënyrë të favorshme çdo auditim në vendpunim, të kryer nga anëtarët e stafit të CEB ose palët e treta të përcaktuara, i cili do të mbulohet me shpenzimet e Huamarrësit.

6.4 Informacion për Projektin

Huamarrësi mban të dhënat kontabël në lidhje me Projektin, të cilat do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke treguar, në çdo moment, gjendjen e progresit të Projektit dhe që regjistron të gjitha përdorimet e bëra dhe identifikon asetet dhe shërbimet e financuara pjesërisht me Huanë.

Huamarrësi i dorëzon CEB në kohën e duhur çdo informacion ose dokument në lidhje me financimin ose zbatimin (duke përfshirë në veçanti çështjet mjedisore/sociale dhe të prokurimit) të Projektit, siç CEB mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Huamarrësi informon CEB menjëherë për çdo ngjarje që ndikon në zbatimin e Projektit, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- (i) çdo veprim ose kundërshtim të iniciuar ose ndonjë kundërshtim të ngritur nga ndonjë palë e tretë ose ndonjë ankesë e marrë nga Huamarrësi ose ndonjë çështje gjyqësore që ka filluar ose kanosur ndaj tij në lidhje me prokurimin ose çështjet mjedisore/sociale ose çështje të tjera në lidhje me Projektin; ose
- (ii) çdo miratim ose ndryshim të ndonjë ligji, rregulli ose rregulloreje (ose në zbatimin ose interpretimin zyrtar të ndonjë ligji, rregulli ose rregulloreje) në lidhje me Projektin.

Çdo ngjarje që mund të ketë një ndikim negativ material në zbatimin e Projektit do të përbënte një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në rimbursimin, pezullimin ose anulimin e parakohshëm të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

6.5 Informacion i Huamarrësit

Huamarrësi dorëzon një përmbledhje çdo vit, jo më vonë se data 1 Maj, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për CEB, të buxhetit vjetor të Huamarrësit dhe zbatimit të buxhetit përkatës dhe çdo informacion të tillë mbi gjendjen e tij të përgjithshme financiare, siç mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Huamarrësi informon CEB për çdo Ndryshim Material Negativ menjëherë pasi të jetë në dijeni të tij. Çdo Ndryshim Material Negativ do të përbënte një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në rimbursimin, pezullimin ose anulimin e parakohshëm të Huasë, sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

6.6 Angazhimet Financiare

(a) Mospërputhje e Tërthortë e Detyrimeve

Huamarrësi informon CEB nëse ndodh ndonjë Rast i Mospërmbushjes së Tërthortë të Detyrimeve. Çdo Rast i Mospërmbushjes së Tërthortë të Detyrimeve do të përbëjë një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje "Rast i Mospërmbushjes së Tërthortë të Detyrimeve" nënkupton një situatë në të cilën, pas çdo mospërputhje të detyrimeve në lidhje me të, Huamarrësit i kërkohet ose është i aftë t'i kërkohet ose, pas skadimit të çdo periudhe të zbatueshme kontraktuale të faljes së interesit, do t'i kërkohet ose do të jetë i aftë t'i kërkohet të parapagujë, shlyejë ose përfundojë përpara maturimit çdo Instrument Borxhi ose çdo angazhim në lidhje me të cilën çdo instrument borxhi anulohet ose pezullohet.

Në rast se dispozita e mësipërme nuk zbatohet, do të përbënte një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

7. PARI PASSU

Në rast se nuk zbatohen dispozitat e paraqitura më poshtë sipas Klauzolës 7, do të përbënte një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në rimbursimin, pezullimin ose anulimin e parakohshëm të Huasë, sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

7.1. Renditja

Huamarrësi siguron që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje renditen dhe do të renditen, jo më pak se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të pasigurta dhe të pavarura të tanishme dhe të ardhshme, sipas ndonjë prej Instrumenteve të tij të Borxhit.

Në veçanti, Huamarrësi nuk bën (ose autorizon) ndonjë pagesë në lidhje me ndonjë Instrument tjetër të tillë të Borxhit (qoftë i planifikuar rregullisht ose ndryshe) nëse:

- (i) CEB bën një kërkesë për rimbursim të parakohshëm sipas Neneve 3.3 të Rregulloreve të Huasë; ose
- (ii) ka ndodhur dhe vazhdon një ngjarje ose ngjarje e mundshme e mospërmbushjes së detyrimeve, sipas ndonjë Instrumenti Borxhi të pasiguar dhe të pavarur të Huamarrësit ose ndonjë prej agjencive ose instrumenteve të tij.

Megjithatë, pagesa në lidhje me një instrument të tillë të borxhit është e mundur nëse Huamarrësi:

- (i) njëkohësisht paguan; ose
- (ii) vë mënjatë në një llogari të caktuar për pagesë në datën tjetër të Pagesës së Interesit

një shumë të barabartë me pjesën e njëjtë të principalit të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje aq sa pjesa e pagesës sipas një Instrumenti të tillë të Borxhit mbart ndaj borxhit total të papaguar sipas këtij instrumenti.

Për këtë qëllim, çdo pagesë e një Instrumenti Borxhi që bëhet nga të ardhurat e emetimit të një instrumenti tjetër, për të cilin janë regjistruar në thelb të njëjtët persona që kanë pretendime sipas instrumentit të borxhit, nuk merret parasysh.

7.2. Siguria

Nëse jepet një Garanci për kryerjen e ndonjë prej Instrumenteve të Borxhit të Huamarrësit, Huamarrësi informon në kohë CEB për qëllimet e tij dhe, nëse kërkohet nga CEB, i siguron CEB, brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e CEB, Siguri identike ose ekuivalente për kryerjen e detyrimeve të tij financiare sipas kësaj Marrëveshjeje.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për një Sigurim:

- (a) të krijuar mbi pronën në kohën e blerjes vetëm si siguri për pagimin e çmimit të blerjes ose për pagimin e borxhit të shkaktuar me qëllim të financimit të blerjes së një prone të tillë; ose
- (b) sigurimin e një Instrumenti Borxhi që maturohet jo më shumë se një (1) vit pas datës në të cilën është krijuar fillimisht.

7.3. Klausola me anë të Përfshirjes

Nëse ndonjë nga Instrumentet e Borxhit të Huamarrësit përfshin një Marrëveshje për Klasifikimin e Humbjes, një Marrëveshje të Raporteve Financiare ose dispozita *pari passu* që nuk janë përfshirë në Marrëveshje ose që janë më të rrepta se çdo dispozitë ekuivalente e kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi informon CEB dhe me kërkesë të CEB, me anë të një njoftimi me shkrim, ekzekuton brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e CEB, një amendament në këtë Marrëveshje, për të siguruar një dispozitë ekuivalente në favor të CEB.

7.4. Pagesat paraprake për Palët e Treta

Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht (për të shmangur dyshimet, parapagimi përfshin një riblerje aty ku është e mundur) në tërësi ose pjesërisht ndonjë Instrument të Borxhit dhe ky parapagim:

- (i) nuk është bërë brenda një shumë qarkulluese kredie e cila mbetet e hapur për t'u tërhequr në të njëjtat kushte pas këtij parapagimi; ose
- (ii) nuk është bërë nga të ardhurat e një Instrumenti tjetër të Borxhit që ka një afat të paktën të barabartë me afatin e pa-skaduar të Instrumentit të Borxhit të parapaguar,

Huamarrësi informon CEB. Në këtë rast, dhe me kërkesën e CEB, Huamarrësi i parapaguan CEB brenda dy (2) muajve nga çdo parapagim i tillë shumë e disbursuara sipas Huasë, në përputhje me Nënklauzolën 4.7 në një masë të tillë sa shuma e parapaguar që mbartet në Instrumentin përkatës të Borxhit.

8. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton që:

- (a) nuk është dhe asnjë nga zyrtarët, drejtorët, agjentët ose punonjësit e tij nuk është person i sanksionuar ose nuk është subjekt i një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe të përvokueshme në lidhje me praktikën e ndaluara të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tij

profesionale dhe askush prej tyre nuk ka hyrë ose nuk hyn në marrëdhënie biznesi me Personat e Sanksionuar;

- (b) organet e tij kompetente e kanë autorizuar atë të hyjnë në Marrëveshje dhe i kanë dhënë nënshkruesit (ve) autorizimin për të, në përputhje me ligjet, dekretet, rregulloret, nenet e shoqatës dhe tekste të tjera të zbatueshme për të;
- (c) ekzekutimi dhe dorëzimi, përmbushja e detyrimeve të tij sipas dhe pajtueshmëria me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk:
 - (i) kundërshtojnë ose bien ndesh me ndonjë ligj, statut, rregull ose rregullore në fuqi, ose ndonjë vendim, dekret ose leje të cilës i nënshtrohet;
 - (ii) kundërshtojnë ose bien ndesh me ndonjë Instrument borxhi ose ndonjë marrëveshje tjetër të detyrueshme për të, e cila në mënyrë të arsyeshme pritet të shkaktojë një Ndryshim Material Negativ;
- (d) asnjë ngjarje ose rrethanë nuk ka mbetur e pazgjidhur që përbën një mospërmbushje të detyrimeve sipas ndonjë Instrumenti Borxhi ose ndonjë marrëveshje tjetër, e cila është e detyrueshme për të ose të cilës i nënshtrohen asetet e tij, e cila pritet në mënyrë të arsyeshme të shkaktojë një Ndryshim Material Negativ;
- (e) asnjë Sigurim nuk i është dhënë një pale të tretë në kundërshtim me Nënklauzolën 7.2;
- (f) nuk ka filluar ose nuk është kanosur ndaj tij asnjë çështje gjyqësore, procedim arbitrazhi ose administrativ ose para ndonjë gjykate, tribunali të arbitrazhit ose agjencie e cila mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të çojë në një Ndryshim Material Negativ; dhe
- (g) ka marrë një kopje të Rregulloreve të Huasë, Politikës së Huasë, Politikës së Masave Mjedisore dhe Sociale, Udhëzimeve të Prokurimit dhe Rregullores së Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe i ka marrë parasysh ato.

Përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme konsiderohen të përsëritura në datën e nënshkrimit të secilës Kërkesë për Disbursim dhe në datën e secilës Certifikatë. Çdo ndryshim në lidhje me përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme duhet, për të gjithë periudhën e Huasë, të njoftohet dhe çdo dokument mbështetës t'i sigurohet CEB menjëherë, pasi Huamarrësi të ketë marrë dijeni për ndryshimin.

Nëse ndonjë nga përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme është ose është provuar se ka qenë e pasaktë ose mashtruese në ndonjë aspekt, kjo do të përbënte një ngjarje në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga banka i huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

9. PALËT E TRETA

Huamarrësi nuk mund të ngrejë ndonjë fakt që lidhet, brenda objektit të përdorimit të Huasë, me marrëdhëniet e tij me palët e treta në mënyrë që të shmangë përmbushjen, ose plotësisht ose pjesërisht, të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja.

CEB nuk mund të përfshihet në mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Huamarrësit dhe palëve të treta dhe kostot, pavarësisht nga natyra e tyre, të shkaktuara nga CEB për shkak të ndonjë pretendimi, dhe veçanërisht të gjitha shpenzimet ligjore ose gjyqësore mbulohen nga Huamarrësi.

10. MOS-HEQJA DORË

Në asnjë rast, duke përfshirë vonesën ose ushtrimin e pjesshëm, nuk supozohet se CEB ka hequr dorë në mënyrë të heshtur nga çdo e drejtë që i është dhënë nga Marrëveshja.

11. TRANSFERIMI

Huamarrësi nuk mund të transferojë ndonjë nga të drejtat dhe/ose detyrimet e tij sipas Marrëveshjes pa miratimin paraprak me shkrim të CEB.

Huamarrësi në këtë mënyrë jep pëlqimin e tij për çdo transferim nga CEB të të gjitha ose një pjese të të drejtave dhe/ose detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes.

12. PALIGJSHMËRIA

Nëse është ose bëhet e paligjshme në ndonjë juridiksion që CEB të bëjë, mirëmbajë ose financojë Huanë ose të kryejë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, kjo do të përbënte një rast në lidhje me Nenin 3.3 (h) të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i huave të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka e huave të padisbursuara*) të Rregulloreve të Huasë.

13. MOSZBATIMI I KLAUZOLËS PËR RRETHANAT E PAPARASHIKUARA

Secila Palë pranon që çdo dispozitë e zbatueshme në përputhje me të cilën një Palë mund të kërkojë nga Pala tjetër që të rinegociojë Marrëveshjen ose mund të pushojë së kryeri detyrimet e saj më poshtë, në rast të një ndryshimi të rrethanave të paparashikueshme në kohën e përfundimit të Marrëveshjes, që e bën përmbushjen tepër të rëndë për një Palë e cila nuk ka rënë dakord të marrë përsipër një rrezik të tillë, nuk zbatohet ndaj saj në lidhje me detyrimet e saj sipas Marrëveshjes dhe nuk ka të drejtë për kërkesa sipas kësaj dispozite.

14. LIGJI RREGULLUES

Marrëveshja rregullohet nga rregullat e CEB, siç përcaktohet në dispozitat e Nenit 1, paragrafi 3, të Protokollit të Tretë (datë 6 Mars 1959) të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës (datë 2 shtator 1949) dhe, së dyti, nëse është e nevojshme, nga ligji francez.

15. MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet midis palëve i nënshtrohen arbitrazhit sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të Rregulloreve të Huasë.

Palët bien dakord të mos përfitojnë nga asnjë privilegj, imunitet ose legjislacion para çdo autoriteti juridik ose autoriteti tjetër, qoftë vendas apo ndërkombëtar, në mënyrë që të kundërshtojnë zbatimin e një vendimi të dhënë sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të Rregulloreve të Huasë.

Në çdo veprim juridik që lind nga kjo Marrëveshje, certifikata e CEB për çdo shumë të pagueshme ose normë interesi të zbatueshme sipas Marrëveshjes, në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të jetë prova *prima facie* (e qartë) e kësaj shume ose norme interesi.

16. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi i çdo të dhëne personale të mbledhur sipas Marrëveshjes kryhet nga CEB në përputhje me Rregulloren e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

17. NJOFTIMET

Çdo njoftim (përfshirë çdo dokument ose komunikim) që do të jepet ose bëhet në lidhje me këtë Marrëveshje për CEB ose Huamarrësin do të jetë me shkrim dhe nëse nuk përcaktohet ndryshe, mund të bëhet me letër të regjistruar, postë elektronike ose faksimile. Ky njoftim konsiderohet i marrë nga Pala tjetër:

- (i) në rastin e një letre të dorëzuar dorazi ose të regjistruar, në datën e dorëzimit;
- (ii) në rastin e postës elektronike, vetëm kur merret në të vërtetë në formë të lexueshme dhe vetëm nëse adresohet në një mënyrë të tillë që pala tjetër specifikon për këtë qëllim;
- (iii) në rastin e postës elektronike, e cila përmban një Njoftim Disbursimi, të dërguar nga CEB për Huamarrësin, kur posta elektronike dërgohet; dhe
- (iv) në rastin e një faksi, me marrjen e transmetimit.

Në çdo njoftim të dhënë nga Huamarrësi për CEB me postë elektronike duhet:

- (i) të përmendet referenca e LD në rreshtin e objektit; dhe
- (ii) të jetë në formën e një imazhi elektronik të pa-redaktueshëm (pdf, tif ose ndonjë format tjetër i zakonshëm jo-redaktues i skedarit, i rënë dakord midis palëve) i njoftimit të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar siç duhet për të nënshkruar këtë njoftim në emër të Huamarrësi, bashkangjitur postës elektronike.

Pa ndikuar në vlefshmërinë e njoftimeve me postë elektronike ose faksimile, të bëra në përputhje me këtë Klauzolë, njoftimet e mëposhtme i dërgohen gjithashtu Palës tjetër me letër të regjistruar, të paktën menjëherë në Ditën vijuese të Punës:

- (i) Kërkesat për disbursim;
- (ii) çdo komunikim në lidhje me pezullimin, anulimin dhe/ose rimbursimin e parakohshëm të Huasë ose në lidhje me një njoftim të parapagimit; dhe
- (iii) çdo komunikim tjetër i kërkuar nga CEB.

Palët bien dakord që çdo njoftim i mësipërm (duke përfshirë postën elektronike) është një formë e pranuar e komunikimit, përbën një provë të pranueshme në gjykatë dhe ka të njëjtën vlerë provuese si një marrëveshje e nënshkruar.

Adresa postare, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike (dhe departamenti ose oficeri, nëse ka, për vëmendjen e të cilit do të bëhet komunikimi) i secilës Palë për çdo komunikim që do të jepet ose bëhet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje është:

Për Huamarrësin:

Ministria of Finance and Economy
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3
Tiranë, Shqipëri
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

Për CEB:

Banka për Zhvillim i Këshillit të Evropës
55 Avenue Kléber
75116 Paris
France

Në vëmendje të: Përgjegjësi i Departamentit të Projekteve
Faks: +33 1 47 55 37 52
E-mail: projects@coebank.org

CEB dhe Huamarrësi njoftojnë menjëherë Palën tjetër me shkrim për çdo ndryshim në detajet e tyre përkatëse të komunikimit.

Të gjitha njoftimet që do të jepen ose bëhen sipas ose në lidhje me Marrëveshjen do të jenë në gjuhën angleze ose frënge ose, nëse janë në një gjuhë tjetër, do të shoqërohen me një përkthim të certifikuar të tyre në gjuhën angleze ose frënge, kur kërkohet nga CEB-i.

Të gjitha njoftimet që do të jepen ose bëhen nga Huamarrësi sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, kur kërkohet nga CEB, i dorëzohen CEB së bashku me prova të pranueshme të autoritetit të personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë një njoftim të tillë në emër të Huamarrësit dhe nënshkrimin model të vërtetuar të këtij personi ose personave.

18. TAKSAT DHE SHPENZIMET

Huamarrësi paguan, në masën e zbatueshme, të gjitha taksat, detyrimet doganore, tarifat dhe detyrimet e tjera të çfarëdo natyre, përfshirë tarifat e pullës dhe tarifat e regjistrimit, që lindin nga ekzekutimi, regjistrimi, implementimi, përfundimi ose zbatimi i Marrëveshjes dhe/ose ndonjë dokumenti të lidhur, si dhe i krijimi, përsosja, regjistrimi, zbatimi ose lëshimi i çdo Sigurie të kërkuar sipas Marrëveshjes.

Huamarrësi mbulon të gjitha tarifat dhe shpenzimet (duke përfshirë kostot ligjore, profesionale, bankare ose të këmbimit) të bëra në lidhje me (i) përgatitjen, ekzekutimin, përsosjen, zbatimin, përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose ndonjë dokumenti përkatës; (ii) çdo ndryshim, shtesë ose heqje dorë në lidhje me këtë Marrëveshje dhe/ose ndonjë dokument përkatës; dhe (iii) përgatitjen, ekzekutimin, përsosjen, menaxhimin, zbatimin dhe lëshimin e çdo Sigurie të kërkuar sipas Marrëveshjes.

Pavarësisht nga sa më sipër, Neni 4.7 (*Kosto e arbitrazhit*) e Rregulloreve të Huasë zbatohet në lidhje me kostot e arbitrazhit të përcaktuara në Klauzolën 15.

19. ÇLIRIMI NGA DETYRIMET

Pas ripagimit të të gjithë principalit të papaguar në bazë të Huasë, si dhe pagimit të të gjitha interesave dhe shpenzimeve të tjera që rezultojnë nga Marrëveshja, duke përfshirë veçanërisht ato shuma sipas Nënklauzolës 4.9 dhe Klauzolës 18, Huamarrësi çlirohet plotësisht nga detyrimet e tij që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

Pa cenuar sa më sipër, Huamarrësi ndërmerr, për një periudhë që nuk i kalon gjashtë (6) vjet pas [marrjes së një Raporti të Përfundimit për pranueshmërinë nga ana e CEB/Raportin e Progresit që konfirmon për pranueshmërinë e CEB shpërndarjen e plotë të të gjitha shumave të disbursuara sipas Huasë] (i) për të mbajtur dokumentacionin në lidhje me Projektin; dhe (ii) për të marrë në mënyrë të favorshme çdo vizitë vlerësuese, duke përfshirë lehtësimin e aksesit në vendpunimet përkatëse të Projektit/Nën-projektit të kryera nga anëtarët e stafit të CEB ose palët e treta të përcaktuara.

20. HYRJA NË FUQI

Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët dhe në datën e hyrjes në fuqi të specifikuar në njoftimin e Huamarrësit drejtuar CEB mbi përmbushjen e procedurave të tij të brendshme.

NË DËSHMI TË KËSAJ Palët kanë marrë masa që Marrëveshja të nënshkruhet në dy (2) origjinale nga nënshkruesit e specifikuar më poshtë në emër të CEB dhe Huamarrësit. Secila Palë mban një (1) origjinale.

Për Huamarrësin

03.11.2021, më Tiranë

Delina Ibrahimaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Për CEB

Paris, më 27.10.2021

Rolf Wenzel

Guvernatori

SHTOJCA 1

Përshkrimi i Projektit

I.	LD	2088		
	Huamarrësi	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë		
	Lloji i Huasë	Shuma e Financimit të Sektorit Publik (PFF)		
	Shuma e Huasë	EURO 60 000 000		
	Miratimi nga Këshilli Administrativ i CEB	11 qershor 2021		
II.	Sektori (et) e veprimit	Kujdesi shëndetësor dhe social		
	Punimet / Aktivitetet e Planifikuara	PFF do të financojë pjesërisht shpenzimet e jashtëzakonshme që lindin nga pandemia COVID-19, duke përfshirë: 1. Punësimin e personelit të ri mjekësor: mjekë, infermierë dhe ndihmës infermierë; 2. Punën jashtë orarit për personelin mjekësor dhe jo-mjekësor; 3. Blerjen e pajisjeve mjekësore; 4. Furnizime farmaceutike, siç janë medikamentet ose testet diagnostikuese; 5. Materiale mjekësore konsumi, si maska për fytyrë, doreza dhe mjetet për pastrimin e duarve; 6. Rehabilitimin / Përshtatjen e spitaleve; 7. Vaksinat COVID-19, përfshirë kostot e transportit dhe magazinimit.		
	Vendndodhja	Shqipëri		
	Përfituesit përfundimtarë	Qytetarët e Shqipërisë		
	Kosto totale e Projektit	Minimumi EURO 66 000 000		
	Plani i Financimit	Burimet	Shuma (MEURO)	Pjesa e kostos totale të projektit (%)
		CEB	60	90
		Burime të tjera	6	10
		Totali (MEURO dhe %)	66	100
	Periudha Buxhetore e Pranueshme	Mars2020 – qershor 2022		
	Data e Mbylljes	30 qershor 2022		
III.	Kriteret e Pranueshme	PFF mbulon shpenzimet buxhetore në lidhje me pandeminë COVID- 19 në sektorin "Kujdesi shëndetësor dhe social" të përshkruara në "Punët / Aktivitetet e Planifikuara" më lart. Huamarrësi siguron që të zbatohen masat e mëposhtme: (i) Protokollet e mbrojtjes për personelin shëndetësor duhet të jenë në funksion dhe informacioni, si dhe pajisjet mbrojtëse, të jenë të disponueshme për zbatimin		

	e protokolleve të tilla për të gjithë personelin. (ii) Personeli i sapo rekrutuar, si dhe i gjithë stafi i mobilizuar për shpërthimin e emergjencës, janë të trajnuar mbi procedurat operacionale të shëndetit dhe sigurisë dhe procedurat specifike në lidhje me COVID-19. Trajnimi dokumentohet. (iii) Një plan i menaxhimit të mbetjeve mjekësore dhe dokumentacioni përkatës është në funksion në të gjitha qendrat shëndetësore, si dhe në zonat e reja të ri-synuara, dhe gjatë situatës emergjente ka vazhduar menaxhim i sigurt. (iv) Çdo zonë e ri-synuar për trajtimin e pacientëve të infektuar me COVID-19, e financuar nga kjo Hua, duhet të arrijë standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit, të arritshëm në një situatë të tillë emergjente. (v) Zonat e karantinës dhe izolimit duhet të veprojnë në përputhje me ligjin, duke siguruar karantinë të ligjshme, të nevojshme dhe proporcionale, të aplikuar pa diskriminim dhe duke respektuar dinjitetin njerëzor.
Kostot e Pranueshme	PFF mbulon shpenzimet buxhetore në lidhje me menaxhimin dhe zbutjen e emergjencave COVID-19, të përshkruara më poshtë "Punët / Aktivitetet e Planifikuara" më lart. Shpenzimet e pranueshme për financimin e CEB mund të përfshijnë: 1. Sondazhet ose studimet përgatitore (planet teknike, ekonomike ose tregtare, inxhinierike, mjedisore dhe sociale të ndikimit dhe planet e menaxhimit) të mbikëqyrjes teknike të projektit dhe shërbimet e tjera profesionale që lidhen me projektin. Këto kosto nuk duhet të kalojnë 5% të koston totale të projektit, përveç nëse justifikohet; 2. Ndërtimi / rinovimi / modernizimi ose blerja e ndërtesave të lidhura drejtpërdrejt me një projekt; 3. Mirëmbajtja e zbatueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve publike; 4. Blerja e materialeve, pajisjeve dhe makinerive, duke përdorur teknologjinë TI dhe softuerin, si dhe kostot përkatëse që lidhen me trajnimin e stafit; 5. Kontingjentet për kostot e papritura (rritjet teknike dhe/ose të çmimeve) mund të financohen nga CEB. Këto përfaqësojnë mbulimin financiar të ndryshimeve të paparashikuara në sasinë e punës së kërkuar, ose të çmimeve për njësi, në llojin dhe sasinë e pajisjeve që do të blihen ose në metodën e kryerjes së projektit. Në varësi të sektorit të veprimtarisë dhe përbërësve të ndryshëm të projektit, këto kushte të paparashikuara mund të përfaqësojnë deri në 10% të koston totale të projektit. Përqindja e kontigjencave mund të jetë më e lartë nëse

	justifikohet gjatë vlerësimit. 6. Kostot që lidhen me trajnimin e kualifikuar / profesional dhe fushatat e ndërgjegjësimit të publikut mund të jenë të pranueshme për financimin e CEB, duke marrë parasysh objektivat e tyre brenda kornizës së projekteve. 7. Huatë e CEB nuk mund të mbulojnë kostot e stafit (pagat / rrogat dhe përfitime të tjera të lidhura siç janë pagesat e pensioneve), tarifat financiare dhe elementet jo-cash si amortizimi. Megjithatë, këto kosto mund të konsiderohen të pranueshme kur ato kanë të bëjnë me stafin e përfshirë në menaxhimin e pandemisë COVID-19. 8. Kostot financiare (pagesa dhe/ose ri-financimi i borxheve, detyrimet mbi interesin, marrja e interesit në kapitalin e një ndërmarrjeje, etj.) ose investimet financiare nuk mund të përfshihen në koston e vlerësuar të projektit dhe nuk mund të financohen nga CEB-i. 9. Vaksinat COVID-19, por vetëm nëse plotësojnë kriteret e mëposhtme: (a) janë të autorizuar nga Agjencia Evropiane e Barnave ose Administrata e Ushqimit dhe Barnave të Shteteve të Bashkuara; ose (b) ata janë në WHO EUL (Lista e Përdorimit në rast Emergjence) <u>dhe</u> një nga 11 SRA (Agjencitë Rregullatore të Rënda) 10. TVSH-ja e jo e zbritshme dhe e pakthyeshme dhe kostot e tjera të lidhura me tatimin, jo të zbritshëm dhe të pakthyeshme mund të konsiderohen si kosto të pranueshme.
--	--

IV. Ndikimi social	Ndikimi social i projektit është i lartë pasi PFF do të financojë pjesërisht masat emergjente të Shqipërisë të marra për të zbutur ndikimin e pandemisë COVID-19 në jetën dhe shëndetin e qytetarëve të saj. Pas përfundimit të Projektit, ky ndikim shoqëror matet përmes treguesve teknikë të renditur në Shtojcën 6, duke përfshirë listën e materialeve dhe materialeve të konsumit të blera dhe shërbimeve të ofruara.
--------------------	--

SHTOJCA 2

Forma e Opinionit Ligjor (Marrëveshje Kuadër Huaje)

[VENDOSNI KOKËN E LETRËS]

Banka për Zhvillim të Këshillit të Evropës
55, avenue Kléber
75116 Paris (France)

Në vëmendje të: Departamentit të Projekteve
Për dijeni: Zyra e Këshilltarit të Përgjithshëm

[VENDOSNI DATËN]

Re: Marrëveshja Kuadër e Huasë ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe [●]
(Ref: LD 2088 (2021))

I nderuar Zotëri, Zonjë,

Në cilësinë e Ministrit të Drejtësisë, i referohem sa më sipër (____), datë (____), dhe anekseve të cilat përbëjnë një pjesë integrale të saj (në vijim referuar si "Marrëveshja"), ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i Republikës së Shqipërisë (në vijim referuar si "Huamarrësi"), për një shumë maksimale _____.

Unë jap këtë mendim ligjor në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë e huasë shtetërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Ky opinion do t'ju jepet vetëm pas shqyrtimit të dokumenteve të listuara më poshtë, dhe në përputhje me ligjin shqiptar përkatës, në fuqi që nga data e këtij akti.

Për dhënien e mendimit të shprehur më poshtë, unë, Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë kam shqyrtuar sa vijon:

- (i) një kopje e ekzekutuar e Marrëveshjes _____, datë _____ midis Huamarrësit dhe _____ të hyrë në fuqi më _____, për projektin e përmendur më sipër, së bashku me një kopje të Rregullores së Huasë.
- (ii) kushtetutën dhe të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, dekretet, urdhërat, politikat dhe procedurat (kolektivisht ligjet) e Shqipërisë lidhur me ekzekutimin dhe shpërndarjen e marrëveshjeve ndërkombëtare.
- (iii) Provat dokumentare të të gjitha veprimeve të nevojshme parlamentare dhe qeveritare që autorizojnë ose ratifikojnë ekzekutimin dhe dorëzimin e Marrëveshjes _____, përfshirë kopjet e(a) Vendimit të Këshillit të Ministrave të miratimit në parim nr. _____, datë _____, dhe (b) ratifikimin e Ligjit Nr. _____, datë _____, bashkangjitur këtu si Aneksat A dhe B.
- (iv) Çdo ligj tjetër ose dëshmi dokumentare që e kam konsideruar të rëndësishme për qëllimin e dhënies së këtij opinion ligjor.

Bazuar në sa më sipër, në emër të Huamarrësit, unë jam i mendimit që nën dhe në respekt të ligjeve aktuale të Republikës së Shqipërisë, marrëveshja është autorizuar siç duhet, ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe është juridikisht e vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme për Huamarrësin në përputhje me kushtet e tij. Veçanërisht, ligji i qeverisë dhe dispozitat e mosmarrëveshjes të përcaktuara përkatësisht, në nenin 14 dhe nenin 15, të Marrëveshjes janë ligjërish të vlefshme dhe të detyrueshme për Huamarrësin sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Përmbajtja e këtij mendimi juridik është e kufizuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe e kufizuar në faktet dhe ligjet ekzistuese në datën e këtij mendimi dhe në asnjë kohë të mëvonshme. Unë nuk kam bërë një rishikim të pavarur të ligjeve të asnjë shteti tjetër përveç Republikës së Shqipërisë. Prandaj, unë nuk shpreh asnjë mendim për çështjet që rregullohen nga ligjet e ndonjë shteti ose juridiksioni tjetër.

Ky opinion ju dorëzohet në lidhje me huanë e përmendur më lart, dhe nuk mund të përdoret nga ju për ndonjë qëllim tjetër ose të mbështetet në të, ndonjë person ose entitet tjetër përveç pasardhësve ose caktimeve tuaja.

E dhënë me dorën time dhe vulën e zyrës në datë _____ 20__, Tiranë, Shqipëri.

Sinqerisht Juaji,

[●]

[VENDOSNI EMRIN(AT)/TITULLIN (JT)]

SHTOJCA 3

KËRKESA PËR DISBURSIM (MODELI)

LD 2088 (2021)– [•] Transhi

Duke iu referuar Marrëveshjes Kuadër të Huasë të datës [•] (në vijim, "Marrëveshja") ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (në vijim "CEB") dhe [HUAMARRËSIT] (në vijim "Huamarrësi"), Huamarrësi me anë të kësaj letre kërkon që CEB, në përputhje me Nënklauzolën 4.3 (a) të Marrëveshjes, të vazhdojë me disbursimin e një Transhi sipas termave dhe kushteve specifike të paraqitura më poshtë.

Termet e përcaktuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim këtu, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Monedha/Shuma ²	[•]		
Data e Disbursimit	[•]		
Periudha e Shlyerjes së Principalit	[•] vjet [duke përfshirë një periudhë faljeje interesi prej [•] vjet]		
Data (at) e Shlyerjes së Principalit	[•]		
Data e Maturimit	[•]		
Norma e Interesit	Fiksuar	Maksimumi [•] në vit	
	Luhatëse	Norma e Referencës	[[•]-muaji EURIBOR / VENDOSNI NDONJË NORMË TJETËR REFERENCE] në vit
		Diferenca	Maksimumi [•] pikë bazë
Periudha e Interesit	[Tremujor] [Gjashtëmujor] me vonesë		
Datat e Pagesës së Interesit	Pagesa e interesit do të bëhet në [•] çdo vit dhe për herë të parë më [•]		
Marrëveshja e Përcaktimit të Ditëve	Ndryshuar pas Marrëveshjes së Ditës së Punës		
Dita e Punës	[•]		
Llogaria e Huamarrësit	Emri i Përfituesit	[•]	
	Banka e Përfituesit	Emri	[•]
		Qyteti	[•]
		SWIFT	[•]
		IBAN	[•]
		Referenca	[•]
	Banka Korresponduese (nëse është e zbatueshme)	Emri	[•]
		Qyteti	[•]
		SWIFT	[•]
		IBAN	[•]

[•], më [•].

Për Huamarrësin

[VENDOSNI EMRIN (T)/ TITULLIN (T)]

² [Në rastin e nën-Transheve, një tabelë e veçantë do të tregojë shumën, periudhën e shlyerjes së principalit, datën (at) kryesore të shlyerjes, normën e interesit, periudhën e interesit, datat e pagesës së interesit për secilën nën-Transhi.]

SHTOJCA 4

NJOFTIMI PËR DISBURSIM (MODELI)

LD 2088 (2021)– [●] Transhi

Në përgjigje të Kërkesës tuaj për Rimbursim të datës [●] duke iu referuar Marrëveshjes Kuadër të Huasë të datës [●] (në vijim, "**Marrëveshja**") ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (në vijim, "**CEB**") dhe [HUAMARRËSIT] (në vijim, "**Huamarrësi**"), CEB me anë të kësaj letre informon Huamarrësin, në përputhje me Nënklauzolën 4.3 (a) të Marrëveshjes, mbi termat dhe kushtet e disbursimit të Transhit përkatës.

Termt e përcaktuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim këtu, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Monedha/Shuma ³	[●]		
Data e Disbursimit	[●]		
Periudha e Shlyerjes së Principalit	[●] vjet [duke përfshirë një periudhë faljeje interesi prej [●] vjet]		
Data (at) e Shlyerjes së Principalit	[●]		
Data e Maturimit	[●]		
Norma e Interesit	Fiksuar	[●] në vit	
	Luhatëse	Norma e Referencës:	[[●]-muaji EURIBOR / VENDOSNI NDONJË NORMË TJETËR REFERENCE] në vit
		Diferenca	[●] pikët bazë
Periudha e Interesit	[Tremujor] [Gjashtëmujor] me vonesë		
Datat e Pagesës së Interesit	Pagesa e interesit do të bëhet në [●] çdo vit dhe për herë të parë në [●]		
Marrëveshja e Numërimit të Ditëve	Ndryshuar pas Marrëveshjes së Ditës së Punës		
Ditë Pune	[●]		
Llogaria e Huamarrësit	Emri i Përfituesit	[●]	
	Pala e Përfituesit	Emri	[●]
		Qyteti	[●]
		SWIFT	[●]
		IBAN	[●]
		Referenca	[●]
	Banka Korresponduese (nëse është e zbatueshme)	Emri	[●]
		Qyteti	[●]
		SWIFT	[●]
		IBAN	[●]
Llogaria e CEB	Emri i Përfituesit	Banka për Zhvillim i Këshillit të Evropës	
	SWIFT i Përfituesit	CEFPFRPP	
	Banka e Përfituesit	Emri	Deutsche Bank
		Qyteti	Frankfurt (Gjermani)
		SWIFT	DEUTDEFF
		IBAN	DE44 5007 0010 0928 7384 00

Paris, më [●]

Për Huamarrësin

[VENDOSNI EMRIN (T)/ TITULLIN (T)]

³ [Në rastin e nën-Transheve, një tabelë e veçantë do të tregojë shumën, periudhën e shlyerjes së principalit, datën (at) kryesore të shlyerjes, normën e interesit, periudhën e interesit, datat e pagesës së interesit për secilën nën-Transh.]

SHTOJCA 5

Forma e Certifikatës

[VENDOSNI LETRËN ME KOKË]

Drejtuar: Banka për Zhvillim të Këshillit të Evropës

Nga: [HUAMARRËSI]

Datë: [JO MË HERËT SE PESË (5) DITË PUNE PARA KËRKESËS PËR DISBURSIM]

Lënda: Marrëveshja Kuadër e Huasë ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe [HUAMARRËSIT] e datës [●] ("Marrëveshja").

I nderuar Zotëri apo Zonjë,

Termat e përcaktuar në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë Certifikatë. Për qëllimet e Nënklauzolës 4.5 të Marrëveshjes, ju vërtetojmë si më poshtë:

- (a) Nuk ka ndodhur asnjë Ndryshim Material Negativ, krahasuar me situatën në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes;
- (b) Nuk ka ndodhur asnjë Ngjarje e Mospërmbushjes së Tërthortë të Detyrimeve
- (c) Asnjë nga Instrumentet e Borxhit të huamarrësit nuk përfshin dispozitat e humbjes së vlerësimit, raportet financiare ose *pari passu* që janë më të rrepta se çdo dispozitë ekuivalente e Marrëveshjes;
- (d) Përfaqësimet dhe garancitë që do të bëhen ose përsëriten nga ne sipas pikës 8 të Marrëveshjes janë të vërteta në të gjitha aspektet; në veçanti, asnjë Siguri nuk i është dhënë një pale të tretë në shkelje të Nënklauzolës 7.2 të Marrëveshjes; dhe
- (e) Asnjë ngjarje ose rrethanë që mund të çojë në rimbursimin, pezullimin ose anulimin e parakohshëm të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3 (*Rimbursimi i parakohshëm i huave të disbursuara*), 3.5 (*Pezullimi nga Banka i kredive të padisbursuara*) dhe 3.6 (*Anulimi nga Banka i Huave të padisbursuara*) të Rregulloreve së Huasë nuk ka ndodhur ose nuk mund të pritët / mund të ndodhë me arsyë.

Për [HUAMARRËSIN]

[VENDOSNI EMRIN (T)/ TITULLIN (T)]

TREGUESIT (Modeli)

Raport Progresi data e ndërprerjes: _____

Referenca e Projektit: LD2088 (2021) Mbështetje e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për të lehtësuar pandeminë COVID-19

Huamarrësi: Republika e Shqipërisë

Ndikimet sociale/Rezultatet		Njësia	Rezultati	Komentet
Pajisjet mjekësore të siguruara (listoni pajisjet e siguruara sipas llojit)	Ventilatorë mekanik/pulmonare ose ekuivalente, duke përfshirë shërbimin dhe mirëmbajtjen	Numër		
	Tjetër	Numër		
		Numër		
		Numër		
		Numër		
Pajisje Mbrojtëse Personale (PPE) (listoni pajisjet e siguruara sipas llojit)	Maska mjekësore për fytyrën (FFP2/FFP3/N95/KN96 ose ekuivalente)	Numër		
	veshje ose ekuivalente	Numër		
	syze ose ekuivalente	Numër		
	doreza ose ekuivalente	Numër		
	PPE të tjera, si këpucë, etj.	Numër		
Teste Laboratorike dhe kosto të tjera për analiza ose diagnozë (PCR, Antitrupa, teste serologjike, etj.)		Numër		
Punëtorë të shëndetësisë që kanë marrë shpërblime/bonuse financiare		Numër		
Punëtorë të shëndetësorë që janë rekrutuar përkohësisht (konsulentë të mjekësisë, infermierë dhe konsulentë të tjerë mbështetës) gjatë emergjencës COVID 19		Numër		
Spitale/qendra shëndetësore të rehabilituara/përshtatur për të trajtuar pacientë me Covid 19		Numër		
Krevate shtesë të llojit të nivelit të tretë (ICU) të pajisur plotësisht, nëse është e zbatueshme		Numër		
Vaksina (listoni vaksinat të pranueshme për financimin e CEB-sipas llojit)		Numër		
Numri i pacientëve që kanë marrë trajtim mjekësor në shtëpi		Numër		